

Fjalim i deputetit Sali Berisha

03.07.2023

Asnjë seancë si kjo e sotmja nuk i ngjet një tragjikomedie të një teatri absurd. Megjithatë, tragjedia është, sepse qytetarët shqiptarë me këtë pseudoreformë kanë humbur një nga të drejtat më themelore të njerëzve të lirë, të drejtën për të pasur një proces ligjor të drejtë.

Në krye të radhës, reforma në drejtësi u projektua, siç e denoncuam në mënyrë të përsëritur dhe e faktuam, si një proces për të shndërruar drejtësinë shqiptare në një degë të ekzekutivit. Sot, de fakto, drejtësia në Shqipëri është një nga degët më të deformatuara të ekzekutivit shqiptar.

Nëpërmjet procesit të vetingut u bë gjahu më i madhi i shtrigave në 32 vjet, u larguan me dhjetëra e qindra gjyqtarë, prokurorë, vetëm e vetëm për përkatësi krahinore, fetare dhe bindje politike. U mbajtën në drejtësi individë me lidhje familjare, me lidhje të fuqishme krimi, me lidhje politike dhe me lidhje ideologjike.

Por nga ana tjetër, në këtë makineri të shkatërrimit të sistemit të drejtësisë, viktimat më e madhe është qytetari shqiptar, se ai sot nuk ka më drejtësi, sepse atij i duhet të presë 10 deri në 20 vjet për një vendim gjyqësor dhe sepse ai duhet të paguajë qimet e kokës ryshfet, së pari, për të afruar pak kohën e gjykimit, lëre pastaj gjykimin të cilin të vetuarit e partisë e kanë me një çmim katërfish më të madh ryshfetin sesa e kishin më parë. Kjo është njëra anë, ajo më tragjika e këtij sistemi, ku qytetari shqiptar nuk gëzon më të drejtën e një procesi të drejtë ligjor.

Mbi 130 mijë dosje në të gjithë sistemin presin shqyrtim, pa llogaritur këtu dosjet e pafundme të prokurorëve, të cilët janë jashtë çdo mundësie reale për trajtimin dhe shqyrtimin e tyre në kohë.

Aspekti tjetër dramatik është se kjo reformë ka sjellë dhe mban në pushtet grupin politik më të korrumpuar, më të inkriminuar, që nga koha e byrosë politike e deri më sot në Shqipëri. Sot njëri pas tjetri këtu flasin dhe ku t'i kapësh, nga Nikua i satelitëve, që është më anodin, tek Ulusiu i krimit elektoral, dhe spiunit të Gjushit, që i thotë Gjushit: "Ik mbathja në Dubai se do të arrestohesh", tek Damiani, që me urdhër të Edi Ramës i dha Deripaskës dhe McGonigalit fushat e naftës dhe sot Shqipëria...

Absolutisht, do të dënohesh nga drejtësia amerikane, këtu do të jemi, se drejtësia shqiptare nuk të dënon ty. Ai zotëria deklaroi se McGonigal është kohë e shkuar, po ai nuk është kurrë kohë e shkuar, do ta shikosh ti mirë...

Deri tani janë paguar 10 milionë. Pritet të paguajnë, për veprimin e tij, edhe 40 milionë të tjera për licensat që ua hoqi kompanive dhe ia dha Deripaskës. Po, po, ja ku është! Pale, kjo ndrikulla e energjisë, ku është ajo?

Ku është zonja që është bërë si kuçedra e digave me Edi Ramën? Që zbrazin digat për të vjedhur shqiptarët; që sasinë kolosale të ujit dhe të energjisë së digave e derdhin, e shesin te sekserët e tyre,

vetëm e vetëm për të marrë pastaj paratë në bursë; që krijojnë bursën e energjisë dhe nuk kanë shitur asnjëherë në të deri tani, sepse të gjitha i shesin jashtë bursës.

Ja kjo Balluku, zëvendësja e Ramës, bashkë me Ramën: janë koha e shkuar këto?! Këto janë sot, dhe shqiptarët po vidhen si kurrë ndonjëherë më shumë.

Pa lëre më, papagallin e Ramës. Në të gjitha institucionet flasin për Salarjonin, sesi e lumturoi kunatin ai dhe kunati atë, gjithçka nga Elisa, Pandeli. Lum si ato!

Erdhi si erdhi, ja ku është 5-milionshe. 5 i thënsnin, se tani të jesh e sigurt që me llogari offshore të tjera mund të shkojnë 15, në mos 30.

Po Rama vetë? Klani i tij është më i korruptuari në Europë dhe në Ballkan. Po flas për energjinë.

Keni pasur një drejtor që quhej Ardian Çela, akuzohej se energjinë po e gllabëron Bitcoin. Pra, serverat e mëdha të Bitcoin-it në fermat e Bitcoin-it. Po kush i ka fermat e mëdha të Bitcoin-it, po ju pyes ju? Gentian Sharra? Jo! Gjici? Jo! Fermat e Bitcoin-it i ka Amant Josifi e Olsi Rama, siç thotë populli.

Edi Rama firmos në kundërshtim me ligjin 420 milionë djegësa; në kundërshtim me Kushtetutën firmos Portin e Durrësit; në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit... Ku është kjo ministria e Jashtme? Është pas pronave strategjike. Prandaj, 10 herë më shumë e meritojnë ata që janë te 313-ta të ishin këtu sot, sesa ju.

Më thoni, kush nga ata që janë te 313 ka marrë një resort turistik, dhjetëra milionë? Pa më thoni se cili prej tyre ka vjedhur e ka firmosur 420 milionë? Më thoni se cili prej tyre po zbraz digat? Më thoni, më thoni, ja ku jemi! Dilni këtu! Më thoni cili prej këtyre ka fituar 100 tenderë me ndërmjetësimin e bashkëkumarxhiut? 100 milionë tendera?

Një minutë, se do t'ua numëroj me radhë tani. Me radhë! Ulusi, krimi elektoral yti do të ndëshkohet dhe do të të ndjekë gjithë jetën. Ja po ta them këtu. 10 herë më mirë të ishte Ymer Lala në atë vend, sesa ti, që të jesh i qartë. Është më i sinqertë ai, ti je dhe hipokrit.

Kjo nuk është dita e drejtësisë. Çfarë të themi? Si mund të jetë dita e drejtësisë? Kjo është dita e turpit! Merret dhe arrestohet Gjushi. Pa më thoni pak: a nuk është Erion Veliaj shumëfishi i Gjushit? A nuk është Erion Veliaj njeriu që po tradhton qytetarët e Tiranës, duke paguar 18 euro më shumë për djegësin e tij që nuk ekziston mbi tokë? A nuk është Erion Veliaj ai që thoshte: "SKAP-in e kam në dorë dhe do t'ia vërsul Dukës së futbollit"? A nuk është Erion Veliaj që i dalin pallatet brenda natës? Është, apo jo? I Arben Malokut, e tjetrit, tjetrit me radhë...

. Me cilën drejtësi vini këtu në parlament, më thoni mua? Ç'lidhje keni ju me drejtësinë? Absolutisht, që të gjithë jeni kontigjent për 313-tën me veprat që keni kryer. Prandaj edhe bërtisni: "Rroftë drejtësia!", se për ju dosjet mbyllen; se për ju nuk ka dosje, se për ju nuk guxojnë...